



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.50/2017

Prishtinë, më 6 mars 2017

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Etem Arifi, Shukrije Bytyqi dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Nenad Rashiq dhe Teuta Haxhiu.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Edi Gusia dhe Leonora Selmani-ABGJ, Albulena Avdiu-Ekonomia online, Sanije Berisha-OSBE, Edona Kurteshi-Koha Ditore, Shpëtim Sadiku- Praktikant dhe Eugen Cakolli- KDI.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit. Komisioni i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite:

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme;**
- 2. Informimi i përfaqësuesit të Agjencisë për Barazi Gjinore;**
- 3. Shqyrtimi i Peticioneve;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtura më 13 shkurt 2017, u miratua pa vërejtje.

2. Informimi i përfaqësuesit të Agjencisë për Barazi Gjinore

Kryetarja lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, fjalën ia dha përfaqësuesit të Agjencisë për Barazi Gjinore.

Edi Gusia, kryeshefe ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore, tha se kjo Agjenci funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe përbëhet nga katër divizione.

Pozita e pafavorshme ekonomike e grave në Kosovë pengon fuqizimin e tyre ekonomik, legjislacioni i Kosovës nuk është diskriminues në fushën e trashëgimisë dhe të drejtave pronësore, por realiteti në Kosovë tregon se gratë janë në pozitë të pafavorshme, në këto aspekte, si çështja e trashëgimisë dhe qasja në pronë. Nisur nga kjo gjendje, në vitin 2016 i kemi propozuar Qeverisë, masë afirmative për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve.

Kjo masë konsiston në faktin e regjistrimit të pronës në emër të dy bashkëshortëve pa pagesë, kemi rezultatet e para që kjo masë afirmative ka pasur suksese, gjatë vitit 2016 kemi 620 raste të çifteve të reja të cilat kanë regjistruar pronën në emër të dy bashkëshortëve.

Gjatë vitit 2016 janë 12 përfitues organizata joqeveritare që kanë përfituar subvencione nga Agjencia për Barazi Gjinore. Po ashtu gjatë atë viti kemi finalizuar edhe raportin për zbatimin e planit të veprimit për rezolutën 1325 dhe me këtë është përmbyllur cikli i raportimit të planit të veprimit për këtë rezolutë.

Po ashtu gjatë vitit 2016 kemi vazhduar edhe me prezantimin e Ligjit për Barazi gjinore, në pesë rajone të Kosovës, ku kanë marrë pjesë diku 590 pjesëmarrës. Akti nënligjor i cili buron nga Ligj për barazi gjinore, që ka të bëjë me përshkrimin e detyrave të punës për zyrtarët për barazi gjinore, në ministri dhe komuna është hartuar nga agjencia dhe është miratua nga qeveria në shtator të vitit 2016.

Një segment tjetër i aktiviteteve të Agjencisë, ka qenë i fokusuar edhe në trajtimin e fenomenit të dhunës në familje, kemi vazhduar të afrojmë trajnime për procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje.

Dy iniciativat që i kemi filluar në vitin 2016 do t'i lansojmë më 8 mars, është monitorimi i programit të Kosovës për barazi gjinore 2008-2013, ky program është hartuar në vitin 2007, dhe ishte miratuar në prill të vitit 2008, dhe është përmbyllur e ligjit për barazi gjinore, pasi sipas këtij ligji qeveria obligohet të raportojë para Kuvendit dhe është hera e parë që ne e dorëzojmë një raport të tillë voluminoz. Disa të gjetura pozitive në këtë raport janë: regjistrimi dhe vijueshmëria e vajzave në sistemin shkollor, e cila është rritur, po ashtu është zvogëluar shkalla e analfabetizmit të vajzat dhe gratë, rritja e numrit të grave në mësimdhënie, korniza ligjore për trajtimin e rasteve të prekura nga dhuna në familje është e kompletuar.

Sfidë e institucioneve të Kosovës mbetet ri integrimi dhe fuqizimi ekonomik i grave viktime të dhunës në familje, po ashtu sfidë mbetet edhe një sistem i qëndrueshëm financimi, MPMS për strehimoret në nivel vendi ka filluar të zbatojë një financim të rregullt në baza mujore.

Shukrije Bytyçi vlerësoi punën e mirë nga Agjencia për barazi gjinore, ndërsa si brengë theksoi çështjen e punësimit të grave, veçanërisht të grave të dhunuara gjatë luftës, të cilat gjenden nëpër strehimore dhe do të ishte mirë të jetë një objekt që bënë një riaftësim të tyre, që ato në të ardhmen, të mundë të gjejnë më lehtë një vend të punës. Po ashtu ajo përmendi çështjen e punësimit të nënave me aftësi të kufizuara, që realisht janë nënë mëshirën e njerëzve bamirës. Çka keni menduar për këto dy çështje?

Ajo më pas shtroi edhe çështjen e sistemit më të mirë të zyrtarëve për barazi gjinore në kuadër të Drejtorive për Punë dhe Mirëqenie Sociale, ku e shihni ju se këta duhet me qenë të vendosur për të dhënë kontribut më të madh.

Kujtim Paqaku vlerësoi punën e mirë që po bëhet nga Agjencia, ndërsa sa u përket komuniteteve shtroi çështjen e ndonjë strategjie lidhur me femrat e komuniteteve pakicë që do të riatdhesohen nga shtetet e perëndimit.

Mytaher Haskuka tha se u përmend se 120 akte normative janë dërguar për komentim dhe kanë arritur të komentohen 40 sosh, cila ka qenë arsyeja pse nuk keni mundur me komentua më shumë akte? Ai shtroi çështjen e bashkëpunimit Agjencisë për Barazi Gjinore me Agjencinë e Statistikave në Kosovë dhe a do të këtë ndonjë publikim i ndonjë raporti?

Ai, më pas, u fokusua në udhëzimin administrativ për shitblerjen e patundshmërive, të cilit do ti përfundojë afati i mbetjes në fuqi dhe a është kërkuar vazhdimi i afatit për këtë udhëzim administrativ?

Salihe Mustafa, në lidhje me prezantimin e Ligjit për barazi gjinore, nga ana e Agjencisë në vitin 2016, në pesë regjione, u fokusua të dijë si ka qenë organizimi, si kanë qenë në fokus grupet, para kujt është prezantuar? Ajo u interesua të dijë se kush ka marrë pjesë nëpër trajnimet kundër dhunës në familje, sepse dihet se shpesh nuk po përcillen procedurat si duhet.

Ajo, më pas, pyeti se me cilat sfida ballafaqohet Agjencia për Barazi Gjinore dhe çka mund të ndihmojë Komisioni FunkSIONAL?

Mexhide Mjaku -Topalli theksoi se në raportin që e vitit paraprak, jemi informuar se numri i femrave në polici dhe FSK, është shumë i vogël. A keni ndonjë informacion se si qëndron situata tani? A është numri i femrave në këto institucione në rritje apo në rënie, po ashtu në raportin e vitit të kaluar është përmendur edhe ndërtimi i një çerdheje në brendi të oborrit të Policisë. Pse po ngec kjo çështje, aq më parë kur dihet se ndërtimi i këtyre çerdheve, afon mundësi më të mira, në mënyrë që femrat të jetë më afër punës.

Ajo, më tej, pyeti se a është qartësuar edhe linja buxhetore që do të ndahet kryesisht për zyrën për barazi gjinore, në mënyrë që bashkërisht asamblistët me zyrtarin të dinë ku me i shfrytëzuar ato mjete.

Edi Gusia tha se sa u përket zyrtarëve për Barazi Gjinore nuk mendoj se janë neglizhentë, janë efektive, janë të emëruar që nga viti 2005, dhe janë personat e parë që ballafaqohen me të gjitha sfidat e barazisë gjinore në Kosovë.

Në bazë të këtij përshkrimi të gjithë zyrtarët për barazi gjinore nëpër komuna i përgjigjen kryetarit të Komunës, ndërsa nëpër Ministri i përgjigjen Sekretarit të përhershëm të Ministrisë, pra kjo çështje është e saktësuar mirë se kujt duhet t'i përgjigjen.

Në lidhje me buxhetin, ajo theksoi se Ligji për Barazi Gjinore nuk parasheh Zyra për Barazi Gjinore, por Zyra për Barazi Gjinore, dhe një zyrtari të vetëm nuk mund t'i ndahet buxhet i veçantë.

Ata kanë buxhet për aktivitete që i prezantojnë me planin e tyre të punës.

Ndërsa sa i përket prezantimit të Ligjit për Barazi gjinore është prezantuar në pesë Rajone, si në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Pejë dhe Mitrovicë, në pjesën Veriore dhe Jugore. Kryesisht fokusi ka qenë te gratë asambliste dhe te drejtorët e departamenteve, trajnimi ka qenë për procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje, pastaj fokusi ka qenë te punëtorët shëndetësorë. Kjo është bërë në bashkëpunim me OSBE-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë, sepse te punëtorët shëndetësorë është vërejtur një lloj hezitimi për t'i raportuar rastet e dhunës në familje.

Lidhur me çështjen e riatdhesimit tha se është një strategji që është hartuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Për numrin e pjesëmarrjes së femrave në Polici dhe FSK, i kemi shifrat vetëm nga raporti që e kemi prezantuar në shtator 2016, dhe nuk kemi të dhëna më të vonshme sepse nuk kemi bërë hulumtim tjetër. Ka mbetur e parealizuar çerdhja në Institucionin e Policisë së Kosovës, por qeveria ka miratuar strategjinë zhvillimore të vendit dhe në atë strategji janë dy objektiva që tentojnë ta përshpejtojnë procesin e barazisë gjinore dhe njëra nga këto dy objektiva është ngritja e çerdheve në nivel vendi që mund të jetë në partneritet publiko-privat.

Sa u përket 120 akteve normative të gjitha janë shikuar, por për 40 prej tyre kemi afuar komente dhe kjo nuk ka të bëjë me kapacitetet e agjencisë, por jo të gjitha ato akte normative kanë perspektivë gjinore, është e vërtetë se udhëzimi administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve i skadon afati.

Lidhur me qendrën për riaftësim për gratë e dhunës në familje, tha se nuk mund të zgjidhet kjo çështje përmes një qendre të veçantë, por duhet të jetë pjesë e vëmendjes së përhershme të qendrave për riaftësim profesional të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Lirije Kajtazi tha se pas ndryshimit të ligjit për veterane, Komisioni deri ku ka arritur për trajtimin e viktimave civile të dhunës seksuale gjatë luftës.

Edi Gusia tha se ky Komision është në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale është në procedurë plotësimi i dy pozitave në atë Komision.

Në vazhdim znj. Gusia foli edhe lidhur me çështjet organizative, të administrimit të brendshëm, të numrit të stafit të duhur, çështjeve buxhetore dhe për mbështetjen e donatorëve, të Agjencisë që ajo udhëheq.

3. Shqyrtimi i peticioneve

Lirije Kajtazi tha se në këtë pikë të rendit të ditës, kemi në shqyrtim dy peticione, njëri nga z. Shukri Maxhuni, me nënshkrimet e 10 mijë qytetarëve, të cilin e kemi trajtuar edhe në mbledhjen e Komisionit, të datës 24 janar 2017.

Në lidhje me procedimin e këtij Peticioni, Komisioni FunkSIONAL vendosi që unanimisht parashtruesit t'i drejtohet me një Përfundim.

Kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Z. Shukri Maxhuni, si përfaqësues i 10 mijë qytetarëve të Komunës së Prishtinës dhe më gjerë, në lidhje me mundësinë e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, duhet të veprojë në përputhje me nenin 12 të Ligjit nr. 04/L-025 për Nisma Legjislative.

Lirije Kajtazi theksoi se në lidhje me Peticionin e z. Hamdi Sogojeva, përfaqësues i punëtorëve të ish-njesisë punuese “Ndërtimtaria” KEK - Obiliq, të përjashtuar nga puna, nga ana e kompanisë, fillimisht, propozoi që si Komision të kërkojmë një informatë zyrtare nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Në lidhje me procedimin e këtij Peticioni, Komisioni FunkSIONAL miratoi propozimin e kryetares. Kryetarja, konstatoi se Komisioni nxori këtë:

K Ë R K E S Ë

Luteni që të na njoftoni lidhur me çështjen dhe statusin momental të punëtorëve të Ish- Njesisë Punuese “Ndërtimtaria” - KEK - Obiliq, lidhur me largimin e tyre nga vendi i punës, qasjen dhe rolin eventual të Institucioneve Qeveritare, në raport me këtë çështje.

4. Të ndryshme

Mytaher Haskuka tha se kërkesa e punëtorëve të ish-njesisë punuese “Ndërtimtaria” KEK – Obiliq, ishte e pakuptimtë, sipas mënyrës së formulimit.

Ai njoftoi se ishte në një shtëpi të personave me të meta mendore në Prizren, ata nuk gëzojnë ndonjë ndihmë nga institucionet, por vetëm nga donacionet individuale. Aty ishin rreth 20 persona që kishin probleme mendore, është mirë të kërkojmë nga Ministria e Shëndetësisë të na sjellë ndonjë raport apo informatë lidhur me gjendjen e kësaj shtëpie.

Mexhide Mjaku-Topalli tha se mbledhjen e kaluar kishte edhe një kërkesë, lidhur me vizitën në një shtëpi të fëmijëve në Prishtinë, a është mendua se kur të realizohet kjo vizitë. Bëhet fjalë për një shtëpi të fëmijëve e cila është përmendur se do të mbyllet.

Lirije Kajtazi tha për të gjitha këto çështje, që u ngritën në këtë pikë, do të akordohemi sëbashku dhe vendosim se si të realizohen.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 15:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI